REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.13, datë 21/03/2005

"PËR KALIMIN KAPITAL TË OBJEKTEVE DHE MJETEVE JO KRYESORE DHE DHËNIEN NË PËRDORIM DHE ADMINISTRIM TË BIBLIOTEKAVE, NJËSIVE BASHKIAKE TË QYTETIT TË TIRANËS"

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, gërma "e", Ligjit Nr. 8654, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës, neni 4 dhe 8, gërma "e", "ë", "f", dhe "i", dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.153, dt.03/04/1993 "Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore", pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të bëhet kalimi kapital i zërave: pajisje, instalime teknike, inventar ekonomik dhe vlera e amortizimit përkatës deri më 31/03/2005 Njësive Bashkiake (sipas pasqyrave e librave të inventareve bashkëngjitur). T'u jepen në administrim Njësive Bashkiake godinat e bibliotekave të qytetit të Tiranës. Këto godina publike të përdoren me efekt funksional përdorimi bibliotekë publike (sipas genplaneve e planimetrive bashkëngjitur).

2. Të drejtën e përfaqësuesit të pronarit për bibliotekat publike e ka Bashkia e Tiranës. Vlerat aktive të qëndrueshme të trupëzuara (ndërtesat, bashkë me vlerën e përqindjes së amortizimit deri më dt.31/03/2005), t'i bëhen kalim kapital Bashkisë së Tiranës.

3. Të bëhet transferimi i kontratave të punës pranë Njësive Bashkiake për punonjësit që janë në marrëdhënie punë sipas listës bashkëlidhur. Punonjësit të kalojnë si nëpunës civilë në periudhë prove duke filluar që nga dt.1/04/2005.

4. Ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e Financës, Administrata e Bibliotekave dhe Njësitë Bashkiake për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI